VENDIM
Nr. 14, datë 27.1.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "TPLANI HC" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI "VALBONA", NË LUMIN E VALBONËS, BASHKIA TROPOJË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2300 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/3 prot., datë 25.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "TPLANI HC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali 'Valbona', në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw",

konstatoi se:

- Shoqëria "TPLANI HC" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 99, datë 13.1.2022, ka paraqitur aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali "Valbona", në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- Me e-mailet e dërguara dhe të protokolluara në ERE me nr. 99/1 prot., datë 19.1.2022 dhe nr. 99/2 prot., datë 19.1.2022, shoqëria ka depozituar dhe dokumente shtesë në kuadër të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Apikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "TPLANI HC" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "c" dhe për pikën 2, germat "b, "e" dhe "f".

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni, si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- *germa "b":* aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore për vetë shoqërinë "TPLANI HC" sh.p.k.

- *germa "c":* aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative, së bashku me stafin teknik që do të angazhohet për me prodhimin e energjisë elektrike.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- *germa "a":* shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve.

- *germa "b":* shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitet 2019–2021, si dhe pasqyrat paraprake të vitit 2022. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacionin/dokumentacionin përkatës në kuadër të zbatimit të nenit 11 të kontratës së koncesionit, ku përcaktohet procedura dhe afati për të kryer testimin e veprës.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 *Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:*

- *germa "a":* shoqëria duhet të plotësojë të dhënat në lidhje me *llojin e HEC-it, numrin e njësive gjeneruese, vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit.*

- *germa "b":* shoqëria duhet të informojë ERE-n në rast se ndryshimet e kuotave që kanë ndodhur në strukturën e shoqërisë përgjatë viteve kanë afektuar këtë kontratën e koncesionit të nënshkruar me METE-n.

- *germa "c":* shoqëria duhet të sqarojë/saktësojë përse kërkesa për pikën e lidhjes është bërë për kapacitetin e instaluar 2100 kw, ndërkohë që në kontratën e koncesionit fuqia e instaluar është 2300 kw; duhet të sqarojë pse kërkesa dhe më pas miratimi i pikës së lidhjes është bërë për koncesionarin; të bëjë me dije nëse pika e lidhjes ka ndryshuar.

- *germa "d":* shoqëria duhet të sqarojë statusin e lejes për përdorimin e burimit ujor përkatës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Valbona.

- Kontrata e koncesionit nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.1.2009, ka një afat 35-vjeçar, por sqarojmë se ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/201,5 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 14 vjet nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 16 vjet. Gjithsesi, në rast licencimi të shoqërisë, në fazën përfundimtare do të bëhet përllogaritja e afateve që i mbeten nga periudha koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "TPLANI HC" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Valbona", në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw, për një afat 16-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti